ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **Qendrën Klinike Universitare e Kosovës**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **Pastrimi i Hapsirave të brendëshme, të Objekteve në QKUK-ë 701-23-10641-2-1-1**

ANKESË

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

" AROMA PLUS " SH.P.K.

Rr.Ndue Perlleshi LLA/3
(Adresa)

(Vendi) **PRISHTINË** *(Kodi postar)* **10000**

(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

Mirvete Krasniqi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

(Adresa elektronike) **shpk.aroma@gmail.com**

27.03.2024

(Data e parashtrimit të kërkesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara
AROMA PLUS
Prishtinë

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:
Ankesa i përket grupeve:

1. **Njoftimi për kontrate i datës 05.10.2023.**
2. **Dosja e tenderit e datës 22.02.2024**
3. **Procesverbali i hapjes i datës 27.02.2024**
4. **Njoftimi mbi vendimin e AK-se i datës 15.03.2024**
5. **Vendimi mbi refuzimin e kërkeses për rishqyrtim 22.03.2024**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] **Jo** [ ]

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e LPP-se nga ana e AK-së:
Neni 1 Qëllimi,
Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi,
Neni 59 i LPP-se
Nenin 57 i LPP-se
Neni 51 i LPPse
Nenin 61 te LPP-se

Nenin 28 te rregullores per prokurim publik nr. 001/22

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Të pa kënaqur me Vendimin e AK ''Qendra Klinike Universitare e Kosovës'' për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim për aktivitetin e prokurimit me titull ''Pastrimi i Hapsirave të brendëshme, të Objekteve në QKUK-ë'', me nr. të prok. 701-23-10641-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 701-23-211-211, brenda afatit ligjor, ushtrojmë këtë ankesë pranë OSHP-së:

Pretendimi 1

AK na ka eliminuar neve për një gabim teknik i cili ka ndodhur gjatë dorezimit të ofertës tek formulari i ofertës ku ne vend te validitetit prej 90 diteve, na ka ndodhur gabim Teknik dhe eshte shkruar 15 dite. AK fare lehtë ka mundur ta verteojë se është gabim Teknik për

faktin se LPP-ja për asnjë lloj procedure të zhvilluar nuk kërkon që validiteti te jetë 15 dite pra sipas LPP-se afati me I shkurter kohor I kerkuar eshte për procedure e koutimit te cmimit dhe eshte 30 dite kjo e dëshmonë më së miri faktin se kemi te bejm me gabim Teknik. Nese e shiqojmë sigurinë e tenderit ne e kemi dorëzuar se bashku me oferte dhe validiteti I sigurise se tenderit është 150 ditë apo 60 ditë më shume se aftit I validitetit të kërkuar. Nese I referohemi neni 28 paragrafi 28.6 te rregullores per prokurim public nr.001/22 kërkohet që siguria e tenderit te qëndroj valide prej nje perudhe prej 30 ditë pas skadimit të validitetit te ofertës. Pra siç shihet nga kjo dizpozitë ligjore ne kemi dorezuar sigurinë e tenderit me afat edhe më të gjatë se 30 ditë se sa validiteti I kërkuar I dosjes së tenderit qe ka qene 90 ditë. Andaj besojm se AK na ka eliminuar pa të drejte sepse ky eshte gabim Teknik dhe devijim i vogel i cili fare nuk paraqet asnje ndikim ne oferten financiare dhe se AK e ka te siguruar oferten ne afat prej 150 ditë e që është mjaftueshëm për të vlerësuar ofertën.

Ne me datën 18.03.2024, ju kemi drejtuar KRPP-së me një shkrese, ku kemi kërkuar interpretim ligjor lidhur me këtë çështje, ndërsa me datë 26.03.2024, kemi pranuar përgjigjen nga KRPP, me nr. të protokollit 29/2024, siç shihet qartë edhe nga ky interpretim, AK na ka eleminuar në mënyrë të kundërligjshme, sepse, këtu kemi të bëjmë me një gabim Teknik ose devijim të vogël, që nuk mund të shkaktojnë devijime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat tjera të parashatruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. (Provë: Interpretimi nga KRPP).

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KRPP - RKJN - PPRC
Nr. 29/2024
Dt. 26.03.2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KOMISIONI RREGULLATIV I PROKURIMIT PUBLIK
REGULATIVNA KOMISIJA ZA JAVNE NABAVKE
PUBLIC PROCUREMENT REGULATORY COMMISSION

DATË/A	25.03.2024		
REFERENC-Ë	KRPP-DRR-25-03-45/2024		
PËR/ZA/TO:	OE -AROMA PLUS	Kopja	Arkivi i KRPP-së
PËRMES/PREKO /THROUGH:	Z. Osman Vishaj, Kryetar Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik		
NGA/OD/FROM :	Arbnora Cakolli-Luzha, Zv. Drejtor i Departamentit të Rregullave Ismail Rushiti, Ekspert i Prokurimit në Departamentin e Rregullave -KRPP		
TEMA/SUBJEKAT /SUBJECT:	Përgjigje në Kërkesën e datës 18.03.2024		

Të nderuar

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën-paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP sqaron si në vijim:

Sipas nenit 87 të këtij ligji, përveç interpretimit të dispozitave të këtij ligji dhe legjislacionit dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që janë dhënë me këtë ligj, **në funksion të KRPP-së nuk është edhe Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i tenderëve.**

Neni 32.10 i Rregullores për Prokurimin Publik përcakton si në vijim:

"32.10 Formulari i Dorëzimit të Tenderit duhet të kontrollohet nëse përmbanë të gjitha të dhënat e shënuara dhe ngarkuara në hapat paraprak të përgatitjes së ofertës, dhe të ngarkohet në sistemin e prokurimit elektronik në mënyrë që të mund të dorëzohet tenderi. Është përgjegjësi e ofertuesit që të ngarkoj Formularin e Dorëzimit të Tenderit në sistemin elektronik të prokurimit dhe të dorëzoj tenderin para afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve...".

<u>Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, është kompetencë dhe përgjegjësi e plotë e Autoritetit Kontraktues.</u>

Paragrafit 4 i nenit 59 të LPP-së, përcakton:

"*4.Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve*".

Për të gjithë OE-të që pretendojnë se AK nuk ka bërë vlerësimin e tenderëve në përputhje me kërkesat e vendosura në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, si dhe me dispozitat e LPP-së, LPP ka paraparë mjetet juridike për t'i atakuar vendimet e AK-së (nenet 108/A dhe 109 të LPP-së).

Me respekt,

Mirëpo, në anën tjeter AK ka rekomanduar për kontrate Operatorin Ekonomik ''Laguna'' SH.P.K, me më shumë pa rregullsi dhe gabime tjera, të cilat e kalojnë vlerën e 2%, po i elaborojmë.

Pretendimi 2

AK ka vepruar në kundështim me nenin 59 paragrafi 4 i LPP-se kur ka rekomanduar për kontratë OE i cili është i papërgjegjshëm sepse nuk i plotësotn kriteret e parapara në njoftim per kontratë dhe dosje të tenderit i cili sipas korigjimit të fundit me dt 23.02.2024 kishte kërkuar si në vijim; Kerkesa e dosjes se tenderit sipas korigjimit të fundit **Kërkesa 1. Operatori Ekonomik duhet të ketë një qarkullim financiar me një vlerë të përgjithshme prej së paku 4,000,000.00€, në lëmin e pastrimit të brendshëm apo te ngjashme për tre vitet e fundit.,**

Dëshimia e kërkuar Evidenca 1. OE duhet të ofroj si dëshmi për qarkullim në lëmin e pastrimit të brendshëm apo te ngjashme për tre vitet e fundit(2020,2021 dhe 2022) dhe te dëshmohet me njeren nga pikat në vijim 1.1. raportin ose raportet përkatëse nga një ose më shumë banka; 1.2. evidencë të një police të sigurimit të lëshuar nga një kompani e njohur e licencuar e sigurimeve; 1.3. kopjet e certifikuara të një ose më shumë bilanceve të gjendjes ose ekstrakteve nga bilancet e gjendjes nëse kërkohet publikimi i bilanceve të tillë të gjendjes në kuadër të ligjit në vendine themelimit të operatorit ekonomik; ose 1.4. kopjete raporteve financiare dhe raporteve të menaxhimit të certifikuara nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur; ose 1.5.Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës.

Këtë e themi bazuar në dëshmitë të cilat i kemi siguruar gjatë qasjes në dokumente publike, përmes të cilave vertetohet se OE I rekomanduar për kontratë për ta përmbushur kerkesen e dosjes se tenderit tek qarkullimi financiar ne fushën e pastrimit, ka dorëzuar vertetimin e ATK-se te dates 10.10.2023 ne te cilin e ka përshkruar qarkullimin në lëmin e pastrimit për vitet 2020, 2021,2022,2023 dhe AK e ka pranuar si të mirëqenë. Vlenë të ceket fakti se ne si kompani para fazes se tenderimit kemi kërkuar nga ATK lëshimin e një vertetimi te tillë me qarkullim specifik për pastrim te brendshëm, dhe kemi pranuar nje email permes të cilit ATK-ja konfirmon se nuk lëshon vertetim tatimor me qarkullim

nga një fushë specifike siç është kërkuar në dosje te tenderit. Në lidhje me këtë kemi edhe interpretimin nga ATK të cilin do e dokumentojmë si në vijim:

Besa Kurti <Besa.Kurti@atk-ks.org> Oct 25, 2023, 2:21PM
to Afërdita, me

I nderuari z. Krasniqi,

Siç edhe ju informova ju duhet te drejtohuni ne zyrën e Shërbimit dhe Edukimit të Tatimpaguesve në Regjionin të cilit i përkisni, por te kërkoni dëshmi mbi qarkullimin e jo vërtetim tatimor. ATK ka informata qarkullimin e përgjithshëm të një tatimpaguesi, por nuk ka qarkullim te një tatimpaguesi per një lëmi te caktuar(pastrimi i brendshëm).
Për çdo informatë shtese mund te na kontaktoni ne numrin e telefonit 038/200 250 17

...

Mbi këtë bazë ne dyshojmë se vertetimi në fjalë është i papranueshëm sepse nuk ka as vlefshmëri për arsye se i ka kaluar me dt. 10.01.2024 vlefshmëria prej 90 ditëve kurse hapja e ofertave është bërë me 27.02.2024 dhe AK- komisioni i vlerësimit e ka pranuar si dokument valid duke e rekomanduar per kontratë OE ''Laguna'' SH.P.K. Vërtetimi tatimor i dates 10.10.2023 është me validitet te skaduar prandaj AK nuk është dashur ta rekomandoj per kontratë OE në fjalë por është dashur ta refuzoj ofertën si te papergjegjshme dhe njëkohësisht te kërkoj nga OSHP që i njejti të futet në listen e zeze për shkak të mashtrimit ndaj AK. (prove: vërtetimi i ATK-së i datës 10.10.2023)

Pretendimi nr.2 i OE ''Aroma Plus'' SH.P.K, sipas AK eshte i pa bazuar, citat: ***''Operatori ekonomik I rekomanduar për kontratë LAGUNA i ka deklaratat tatimore për vitin 2020-2021-2022 të cilat e përmbushin kriterin e dosjes së tenderit. Gjithashtu sa i përket vërtetimin tatimor OE i rekomanduar per kontrate ka dorezuar nje vertetim tatimor me qarkullim shtese I cili eshte shume lehte I verifikueshem pasi qe ka numrin serik i cili mund te verifikohet online. Megjithate AK-ja me bindje te plote e konfirmon se OE i rekomanduar per kontrate ka permbushur kriterin e dosjes se teder sa I perkete qarkullimit financiar.''***

Kërkesa e korrigjuar e AK-së ka qenë: **Kërkesa 1. Operatori Ekonomik duhet të ketë një qarkullim financiar me një vlerë të përgjithshme prej së paku 4,000,000.00€, në lëmin e pastrimit të brendshëm apo te ngjashme për tre vitet e funditS**

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Evidenca 1. OE duhet të ofroj si dëshmi për qarkullim në lëmin e pastrimit të brendshëm apo te ngjashme për tre vitet e fundit (2020,2021 dhe 2022) dhe te dëshmohet me njeren nga pikat në vijimë:

1.1. raportin ose raportet përkatëse nga një ose më shumë banka;

1.2. evidencë të një police të sigurimit të lëshuar nga një kompani e njohur e licencuar e sigurimeve;

1.3. kopjet e certifikuara të një ose më shumë bilanceve të gjendjes ose ekstrakteve nga bilancet e gjendjes nëse kërkohet publikimi i bilanceve të tillë të gjendjes në kuadër të ligjit në vendin e themelimit të operatorit ekonomik; ose

1.4. kopjet e raporteve financiare dhe raporteve të menaxhimit të certifikuara nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur ; ose

1.5 . Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës

Pra, siç shihet qartë kërkesa e AK, ka qenë se OE duhet të ketë një qarkullim financiar në tre vitet e fundit 2020,2021,2022, në vlerë prej 4,000.000.00€ në lëmin e pastrimit të brendshëm ose te ngjashme. Mirëpo, per kete kerkese OE i rekomanduar për kontrate ka dorezuar deklarate tatimore për vitin 2020,2021,2022, mirepo, Deklarata tatimore e tregon vetem qarkullimin vjetor per tre vitet e fundit por nuk e tregon se per qfare qarkullimi eshte fjala por e tregon vetem qarkullimin e pergjithshem të tatimpaguesit. Pra, kerkesa e vet AK, ka qene qe qarkullimi duhet te jete ne lëmin e pastrimit te brendshem ose te ngjajshem. Vetem deklaratat per tre vitet e fundit nuk e plotesojne kete kerkese te AK.

Ndersa, AK, ne pergjigjen qe e kemi pranuar si te pa bazuar thote se Vertetimi tatimor eshte nje vertetim shtese I cili shume lehte mund te verifikohet online, mirepo AK ka harruar se ky vertetim tatimor me qarkullim ne lëmin e pastrimit te brendshem per tre vitet e fundit eshte larguar nga kerkesa e AK dhe nuk mund te merret si document shtese per qarkullimin në lëminë e pastrimit te brendshem dhe njëherit eshte dokument jo valid sepse, vertetimi eshte nxjerre me datë 10.10.2023 dhe ky dokument (vërtetimi tatimor) ka validitet 90 ditë, ndërsa ofertat janë hapur me 27.02.2024. (shih vertetimin tatimor).

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transferave - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo -Tax Administration of Kosovo

VËRTETIM TATIMOR
TAX VERIFICATION
PORESKA POTVRDA

Administrata Tatimore e Kosovës verifikon se personi i identifikuar më poshtë:
Tax Administration of Kosovo certifies that the person identified below:
Poreska Administracija Kosova overava da dolje identifikaciono lice:

1001110626

Emri i personit: Name of Person: Ime lice:	LAGUNA SH.P.K.
Numri Identifikues Personal: Personal Identification Number: Identifikacioni Lični Broj:	
Numri Fiskal: Fiscal Number: Fiskalni Broj:	810815285
Komuna: Municipality: Opština:	PRISHTINË
Data: Date: Datum:	10.10.2023
Arsyeja e lëshimit: Reasoning: Razlog izdavanja:	Aplikim për Tender Pastrim I brendshem i obj.Qarkullimi në TVSH;VITI 2020/1,538,774.21 Viti 2021/1,430,922.24 Viti 2022/1,654,355.90 Viti 2023/1,709,794.96 €

ka këtë gjendje tatimore në ATK:
has the following tax position with the TAK:
ima sledeću poresko stanje u PAK:

Personi është i regjistruar në ATK dhe aktualisht është në marrëveshje me këste për të shlyer borxhe tatimore të mbetura
This person is registered with TAK and is currently in an installment agreement to satisfy outstanding tax debts
Lice je registrovana u PAK i aktuelno je u sporazumu u ratama za isplatu ostalih poreskih dugova

ATK vërteton se informatat e dhëna janë të sakta dhe të plota me datën e këtij vërtetimi tatimor, mirëpo, ky vërtetim nuk përjashton obligimet tatimore që mund të lindin në të ardhmen.

ATK certifies that this information is correct and complete as of the date of this verification, but this verification does not exclude future tax obligations.

PAK overava da su date informacije tačne i potpune sa datumom ove potvrde, ali ova podvrda ne isključuje poreska obaveza koja mogu nastati u budućnosti.

Vërtetimi vlen 90 ditë nga data e lëshimit
The verification is valid for 90 days from the day it is issued
Potvrda vazi 90 dana od dana kada je izdata

Verifikimin e këtij vërtetimi tatimor, mund ta bëni në linkun -
Verification of this tax verification, you can do on the link - Verifikaciju ove poreske potvrde, možete uveravati i linku:
https://eVertetimi.atk-ks.org/TaxVer/ReadTaxVer

Pra, duket qartë se kjo kërkesë nuk është plotesuar nga OE i rekomanduar për kontratë, atëherë AK është dashur që menjëherë ta eleminojë e jo ta shpallë fitues, sepse ne vetëm për një gabim teknik na ka eleminuar. Për informimin tuaj, në Vendimin rreth Kërkesës për rishqyrtim nga ana e Autoritetit Kontraktues, të datës 22.03.2024 përkatësisht në faqen 2, në përgjigjjen rreth pretendimit tonë të dytë (2), sa i përket mos për,mbushjes së kriteret të qarkullimit financiar nga ana e Operatorit Ekonomik të shpallur fitues, Autoriteti Konktraktues, përgjigjet, ndër të tjera me fjalën "AK-ja me bindje të plotë e konfirmon se OE I rekomanduar për Kontratë ka përmbushur kriterin e dosjes së tenderit sa i përket qarkullimit financiar". **Nga kjo, të nderuar Panel Shqyrtues, vërehet qartë anshmëria e Autoritetit Kontraktues për të favorizuar OE të shpallur fitues. Fatkeqësisht kjo**

anshmëri, tregohet qartë edhe në formë të shkruar, duke e pranuar publikisht që vendimin e kanë marrë në bazë të bindjes së tyre e jo në bazë të kritereve formale të cilat janë kusht për tu shpërblyer një Operator Ekonomik me Kontratë. Tutje, qasja diskriminuese në këtë rast është e qartë sepse detyrë e Autoritetit Kontraktues nuk është vendimmarrja mbi bazë "të bindjes", por mbi bazën e plotësimin të kritereve ekskluzive formale dhe në bazë të dokumenteve të paraqitura. Pra në rastin konkret, vendimmarrja nga ana e Autoritetit Kontraktues është dashur të bëhet mbi bazën e provave dhe dokumenteve të paraqitura e jo mbi bazën e ushtrimit të diskrecionit. Pra, Autoriteti Kontraktues nuk ka guxuar që të marr vendim mbi bazën e bindjes, por të provave dhe se ushtrimi i DISKRECIONIT NË KËTË LLOJ TË VENDIMMARRJES ËSHTË TOTALISHT I NDALUAR, për çka, vendmimmarja e tyre mbi bazë të "bindjes" e jo mbi bazë të provave, përveç që është në kundërshtim me ligjin, është edhe skandaloze dhe paraqet tejkalim të detyrave dhe përgjegjësive të përcaktuar me Ligj.

Në lidhje me këtë, ju lutem që t'i referoheni nenit 4, paragrafit 4 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili në mënyrë të qartë përcakton si në vijim: ***"4. Pushteti diskrecionar, përmendur në paragrafin 3 të këtij neni, është mundësia që i jepet një organi publik, shprehimisht apo që nënkuptohet me ligj, për të vendosur duke zgjedhur në mes dy apo më shumë veprimeve të ligjshme, për t'i shërbyer në mënyrën sa më të përshtatshme interesit publik".*** **Lidhur me këtë, e njoftojmë Paneli Shqyrtues të Prokurimit, se Operatori Ekonomik "Laguna Shpk", nuk e kishte përfillur asnjërin prej 5 dëshmive për Kapacitetin Ekonomik dhe financiar nga pjesa 8.1 e Dosjes së Tenderit, duke tentuar që me anë të Vërtetimit Tatimor, me afat të skaduar, të tentoj të plotësoj këtë kriter. Në mënyrë të kundërligjshme, Autoriteti Kontraktues e ka anashkaluar këtë pike, ndonëse dokumenti është i kundërligjshëm. Për më tepër, në cilësi të proves materiale, po ju bashkëngjesim emailin e pranuar nga ana e ATK-së të datës 25.10.2023, me të cilin në mënyrë të qartë konstatohet se: "ATK ka informata mbi qarkullimin e përgjithshëm të një tatimpaguesi por nuk ka qarkullim të një tatimpaguesi për një lëmi të caktuar (pastrimi i brendshëm), e që në rastin konkret OE i shpallur fitues, në Vërtetimin Tatimor e ka nxjerrë në kundërshtim me vet rregullimin ligjor të ATK-së. Nisur nga kjo, dukshëm konstatohet se Autoriteti Kontraktues ka qenë në situate kur asnjëra nga pese (5) dëshmitë për Kapacitetin Ekonomik dhe Financiar nuk është plotësuar**

nga OE i shpallur fitues dhe në mënyrë të pakontestueshme është dashur që të njëjtin ta eliminoj nga ky aktivitet i tenderimit.

Pretendimi 3

Në vijim, kërkojmë vëmendjen tuaj të posaçme në analizat e mëposhtme, ku pas kalkulimeve të bëra, vërehen qartë të dhëna disproporcionale në mes vete, anomali në ofrimin e shërbimeve dhe mashtrime të dukshme, ekzistimi i së cilave, jo vetëm që imponon nevojën emergjente për prishjen e vendimit të Autoritetit Kontraktues për dhënien e Kontratës këtij Operatori Ekonomik të papërgjegjshëm, por njëherit në vetvete konsumojnë edhe elemente të qarta të veprave penale që ndërlidhen me prokurimin publik të cilat janë qartazi të sanksionuara me nenin 415 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës e cila i referohet rasteve konkrete të mashtrimit në prokurimin publik, ashtu siç edhe ka ndodhur në rastin konkret.

Pas qasjes në dokumente publike ne kemi pare që analiza financiare e dorëzuar nga OE i rekomanduar nuk I përmbush kriteret e dosjes sepse nuk i ka perfillur obligimet ligjore sa i përketë orëve të nderrrimeve te nates dhe vikendeve/fundjavës:

OE ''Laguna'' SH.P.K e rekomanduar për kontratë nuk ka bërë llogaritjen e orëve të natës dhe ditëve të vikendit, sipas Ligjit të punës 03/L212, sepse vetë kërkesa e AK ka qenë që OE të paraqesin një analizë financiare të detajuar sipas Ligjit të punës.

Tabela nr. 2, Analiza financiare per pagen bruto 402 Euro - 42 punetor per ndrrimet e nates. Pozicioni nr.3, oret e nates 30% nuk është llogaritur konform kerkesës te dosjes se tenderit. Brenda muajit janë 22 ditë pune që do thotë janë 22 ndrrime te natës, kurse për 42 punëtor janë gjithsejtë 42X 22= 924 ndrrime te natës, ku vlera per nje ndrrim te nates është 5.48 € + kontributi i Punëdhënësit 0.27 € gjithsejtë : 5.75 €, pra një ndrrim i natës kushton 5.75 €, kur kjo të shumzohet me numrin e ndrrimeve te natës, shuma është: 924 X 5.75 = 5,313.00 €, kur kjo shumë pjestohet me nr. e punëtoreve 42: 5313.00 € : 42 punetor = 126.5 € për një punëtor brenda nje muaji, ndersa OE i rekomanduar per Kontratë, per kete pozicion nr.3 oret e natës 30% ka dhene çmimin prej 40.20 për një punëtor për një muaj.

Nga kjo qe u cek me lartë, shihet qartë se OE, në këtë pozicion nuk i ka llogaritur ndërrimet e natës, konform kriterit te dosje, bazuar ne ligjin e punes, ku kjo diferece është: 5,313.00 – 1,688.40 = 3,624.60 €, pra nje diference mujore prej 3624.60 €, e kjo kur te shumëzohet me 36 muaj eshte e barabarte: **3624.60 X 36 = 130,485.60€.**

Tabela nr. 3, Analiza financiare per pagen bruto 402 Euro - 42 punetor Vikende dhe Festa

Brenda muajit janë 8 vikende, kur kete e shumzojme me 42, atehere kemi: 42X 8= 336 vikende, ku vlera per nje vikend është 9.14 € + kontributi i Punëdhënësit 0.46 € gjithsejtë : 9.6 €, pra një vikend ka çmimin prej 9.60 €, kur kjo të shumzohet me numrin e vikendeve, shuma është e barabart 336 X 9.6 = 3,225.60 €, kur tani, kjo shumë pjestohet me nr. e punëtoreve 42: 3,225.60 € : 42 punetor = 76.8 € për një punëtor brenda nje muaji, ndersa OE i rekomanduar per Kontratë, per kete pozicion nr.3, tabela 3, per vikende (50%) ka dhene çmimin prej 57.37 per një punëtor per nje muaj.

Edhe këtu shihet qartë se OE, në këtë pozicion, pozic. 3, tabela 3, nuk i ka llogaritur vikendet konform kriterit te dosjes, bazuar ne Ligjin e punes, ku kjo diference është: 3,225.60 € - 2,409.54 € = 815.46 €, pra nje diference mujore prej 815.46 €, e kjo kur te shumëzohet me 36 muaj eshte e barabarte: **815.46 X 36 = 29,356.56 €,** ndërsa festat janë llogaritur sipas Ligjit, sepse çdo muaj llogaritet nga nje dite feste.

Nga kjo qe u cek me larte shihet se OE i rekomanduar per kontrate, ka Gabim aritmetikor me shume se 2%, sepse kur te mblidhen keto dy pozicione kapin shumen prej :

130,485.60 € + 29,356.56 € = 164,842.16 €

Pra, diferenca për këto pozicione për tri vite është 164,842.16€ dhe ky gabim I dy pozicioneve në fjalë e bënë ofertën totalisht të papërgjegjshme konform nenin 59 paragrafi 3 i LPP-së sepse tejkalon gabimin aritmetikor prej 2% të ofertës. " neni 59 paragrafi 3 I LPP-se "*Autoriteti Kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të* ***jetë më shumë se dy përqind (2%) i vlerës*** *totale të ofertës. Në një rast të tillë, çmimi për njësi i ofertuar nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohet si çmim mbizotërues mbi çdo çmim tjetër kontradiktor. Kur nuk kërkohen çmimet për njësi, elementet e çmimit të vetëm të çmimit total të ofruara nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohen si çmim mbizotërues mbi çmimin total. Autoriteti kontraktues menjëherë do ti dërgojë të gjithë tenderuesve përkatës një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla".*

Pra, edhe pergjigja e AK per pretendimin nr.3 eshte e pa bazuar sipas AK dhe se AK kete pretendim thote se eshte ne harmoni me Ligjin dhe se OE I rekomanduar per kontrate ka dorezuar Analizen financiare sipas Ligjit te punes dhe ATK-së, duke u thirrur në atë se ka respektuar nenin 1 të LPP-së para qëllimit duke rekomanduar për kontratë OE më të lirë të pergjegjshem ne menyre qe te mund te shfrytezohen mjetet ne menyre sa me transparente,

mirepo shihet qartë se AK në këtë pike manipulon duke thënë se OE I rekomanduar per kontrate I ka kalkuluar të gjitha kërkesat, festat, vikendet sipas Ligjit. Ky arsyetim I AK nuk qëndron për faktin se OE I rekomanduar per kontratë nuk I ka kalkuluar sipas Ligjit ditet e vikendeve. Pra, ne kemi dhënë sqarimet tona më lartë rreth kësaj analize financiare, ku shihet qarte se OE I rekomanduar për kontrate, ditët e ndrrimeve të natës dhe vikendeve nuk janë llogaritur konform kërkesës së AK-së (Ligjit të Punës nr. 03/L-212) dhe se AK është dashur menjëhere ta eleminojë nga gara këtë OE, sepse kur të llogaritet pozicioni I nderrimeve te nates dhe vikendeve, sipas Ligjit atëhere del se gabimi aritmetikor është më shumë se 2%, ashtu siç e kemi potencuar më larte. Pra, edhe dy OE tjere qe jane eleminuar nga ky aktivitet I prokurimit, kanë bere kerkese për rishqyrtim dhe ata janë ankuar në lidhje me qështjen e analizës financiare sepse, ndërrimet e nates dhe vikendet nuk janë llogaritur sipas Ligjit. Në platformen elektronike e-prokurimi mund ti gjeni kerkesat per rishqyrtim. (shih analizen financiare)

TAB: 1

ANALIZA FINANCIARE PËR PAGËN BRUTO 402 EURO - 239 PUNËTOR ME ORAR TË RREGULLT PUNE

	Përshkrimi i aktivitetit/obligimeve	Nr. I punetoreve	Paga Bruto e Punetorit - muaj	Vlera Mujore	Vlera 12 Mujore
1	Paga bruto	239	402.00	96,078.00	1,152,936.00
2	Pushimi vjetor	239	30.45	7,278.64	87,343.64
3	Gjithsejt paga bruto, pushimi vjetor(1+2)	239	432.45	103,356.64	1,240,279.64
4	Trusti pensional 5% i punëdhënësit	239	21.62	5,167.83	62,013.98
5	Gjithësjet Kostoja për një punëtor (3+4)	239	454.08	108,524.47	1,302,293.62
6	**Kostoja Totale për 239 punëtor**	**239**	**454.08**	**108,524.47**	**1,302,293.62**

TAB: 2

ANALIZA FINANCIARE PER PAGËN BRUTO 402 EURO - 42 PUNËTOR PER NDRRIMET E NATËS

	Përshkrimi i aktivitetit/obligimeve	Nr. I punetoreve	Paga Bruto e Punetorit - muaj	Vlera Mujore	Vlera 12 Mujore
1	Paga bruto	42	402.00	16,884.00	202,608.00
2	Pushimi vjetor	42	30.45	1,278.90	15,346.80
3	Oret e nates 30%	42	40.20	1,688.40	20,260.80
4	Gjithsejt paga bruto (1+2+3)	42	472.65	19,851.30	238,215.60
5	Trusti pensional 5% i punëdhënësit	42	23.63	992.57	11,910.78
6	Gjithësjet Kostoja për një punëtor (4+5)	42	496.28	20,843.87	250,126.38
7	**Kostoja Totale per 42 punëtor**	**42**	**496.28**	**20,843.87**	**250,126.38**

TAB: 3

ANALIZA FINANCIARE PER PAGËN BRUTO 402 EURO - 42 PUNËTOR ME VIKENDE DHE FESTA

	Përshkrimi i aktivitetit/obligimeve	Nr. I punetoreve	Paga Bruto e Punetorit - muaj	Vlera Mujore	Vlera 12 Mujore
1	Paga bruto	42	402.00	16,884.00	202,608.00
2	Pushimi vjetor	42	30.45	1,278.90	15,346.80
3	Oret e vikendeve	42	57.37	2,409.54	28,914.48
4	Oret e festave 50%	42	9.14	383.71	4,604.54
5	Gjithsejt paga bruto (1+2+3+4)	42	498.96	20,956.15	251,473.82
6	Trusti pensional 5% i punëdhënësit	42	24.95	1,047.81	12,573.69
7	Gjithësjet Kostoja për një punëtor (5+6)	42	523.90	22,003.96	264,047.52
8	**Kostoja Totale per 42 punëtor**	**42**	**523.90**	**22,003.96**	**264,047.52**

TAB: 4

ANALIZA FINANCIARE PËR PAGËN BRUTO 402 EURO - 3 PUNËTOR - STRUKTURA MENAXHUESE

	Përshkrimi i aktivitetit/obligimeve	Nr. I punetoreve	Paga Bruto e Punetorit - muaj	Vlera Mujore	Vlera 12 Mujore
1	Paga bruto	3	402.00	1,206.00	14,472.00
2	Pushimi vjetor	3	30.45	91.36	1,096.36
3	Gjithsejt paga bruto, pushimi vjetor(1+2)	3	432.45	1,297.36	15,568.36
4	Trusti pensional 5% i punëdhënësit	3	21.62	64.87	778.42
5	Gjithësjet Kostoja për një punëtor (3+4)	3	454.08	1,362.23	16,346.78
6	**Kostoja Totale për 3 punëtor**	**3**	**454.08**	**1,362.23**	**16,346.78**

RIKAPITULIM

	Përshkrimi i aktivitetit/obligimeve	Nr. I punetoreve	Paga Bruto e Punetorit - muaj	Vlera Mujore	Vlera Vjetore
TAB.1	Kosto totale për: Pastrues te rregullt 239 me pagë mujore bruto 402 €	239	402	108,524.47	1,302,293.62
TAB.2	Kosto totale për: Pastrues shtese me ndrrime dhe festa 42 me pagë mujore bruto 402 €	42	402	20,843.87	250,126.38
TAB.3	Kosto totale për: Pastrues shtese per vikende dhe festa 42 me pagë mujore bruto 402 €	42	402	22,003.96	264,047.52
TAB:4	Kosto totale për: Struktura menaxhuese 3 me pagë mujore bruto 402 €	3	402	1,362.23	16,346.78
	KOSTO TOTALE (Tab.1+Tab.2+ Tab.3+ Tab.4)			152,734.52	1,832,814.29
	FITIMI I PLANIFIKUAR			1.00	12.00
	UNIFORMAT			45.00	540.00
	VLERA E MATERIALIT PER PASTRIM ANEKS 4 SIPAS DOSJES SE TENDERIT			4,722.22	56,666.67
	VLERA TOTALE E OFERTES PA ANEKS 5			157,502.75	1,890,032.96
	TVSH-ja			28,350.49	340,205.93
	TOTALI ME TVSH PA ANEKS 5			185,853.24	2,230,238.89
	VLERA E MATERIALIT PER PASTRIM ANEKS 5 SIPAS DOSJES SE TENDERIT ME TVSH			5,408.33	64,900.00
	VLERA TOTALE E OFERTES ME TE GJITHA PIKAT			191,261.57	2,295,138.89

Pretendimi 4

Pasi kemi pasur qasje ne dokumentacionin edhe te Operatoreve tjere ekonomik, kemi verejtur se analizat finanicare jane perafersisht te ngjajshme sikur se me analizen tone financiare. AK ka shkelur edhe nenin 61 të LPP-se dhe nein 41 të rregullores per prokurim public kur ka rekoamnduar për kontratë OE Laguna shpk për faktin se OE në fjalë tek pozicionioni uniformat për punëtor ka ofertuar me cmim prej 0.12 cent dhe se AK nuk ka kërkuar fare sqarime shtese nga OE se si do te realizoj pozicionin ne fjalë me cmim prej 0.12 cent e që është cmim I parealizueshëm, jo normailisht i ulët dhe po ashtu cmim mashtrues. Bazuar në këtë AK është dashur që ta eliminoje jo ta rekomandoj për kontratë OE ''Laguna'' SH.P.K, sepse ka ofertuar me cmime mashtruese, jo-normalisht të ulëta.

Pra, edhe përgjigja e AK për pretendimin nr.4 është e pa bazuar, sepse mundohet të arsyetojë OE të rekomanduar për kontratë, me faktin se i njëjti ka ende kontratë valide me QKUK dhe ka një marreveshje me një kompani për sponzorizimin e uniformave dhe AK e ka pare të panevojshme që të kërkojë informata shtesë.

Pavarësisht këtyre arsyetimeve kërkesë e AK ka qenë që në Analizën Financiare duhet të përfshihen edhe uniformat, përderisa ka qenë kërkese e AK, atëhere edhe AK kur e ka vërejtur se çmimi për një uniformë eshte vetem 12 cent, është dashur të kërkojë informata shtese nga OE,sepse jane cmime jo normalisht te uleta, por këtë gjë AK nuk e ka bërë dhe kjo është në kundërshtim me LIGJIN NR. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK.

Pretendimi 5

Komisioni I vlerësimit të ofertave ka vepruar në kundërshtim te plotë me nenin 59 të LPP-se dhe këtë e dëshmon edhe njoftimi mbi vendimin e AK-së, ku edhe perkunder të gjitha ketyre mungesave dhe shkeljeve te ligjit dhe kritereve te dosjes se tenderit nga ana e OE ''Laguna'' SH.P.K, komisioni përsëri e ka rekomanduar për kontratë, kurse ofertën tone e cila është në përputhje të plotë me kriteret e dosjes së tenderit dhe me analizë financiare 100% në përputhje me ligjin e punës dhe kritereve te dosjes se tenderit, na kanë eliminuar vetëm për një gabim Teknik e I cili fare nuk ka efekt financiar tek oferta dhe është devijim I vogël, ku shihet qarte se komisioni vlerësues ka qenë jo profesional.

Pra, sikur AK të kishte vlerësuar në përputhje me kriteret e dosjes se tenderit dhe nenit 59 pargarafi 4 I LPP-se oferten tone do ta rekoamndonte për kontratë dhe jo ta eliminonte si të pa përgjegjshme. Neni 59 paragrafi 4 "*4.Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat*

e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. ***Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve".***

Pra, edhe përgjigja e AK për pretendimin nr.5 është e pa bazuar, duke e arsyetuar se AK ka vlerësuar, krahasuar dhe ekzaminuar ofertën konform nenit 59 të LPP-së duke rekomanduar për kontrate oferten me te lire të përgjegjshme. Pra, kjo nuk qëndron sepse, shihet qartë në bazë të pretendimeve të lartëcekura se OE i rekomanduar për kontratë duhet të shpallet I pa përgjegjshëm për shkak se nuk I ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit ashtu siç I parasheh Ligji. Si është e mundur që AK t'i eleminojë katër oferta tjera për disa lëshime ose gabime teknike dhe të shpallë fitues një OE me të gjitha këto të meta dhe gabime aritmetikore dhe t'i eleminojë katër oferta tjera.

Ne besojmë se i kemi elaboruar më shumë se sa që duhet shkeljet e AK-së në këtë aktivitet të Prokurimit andaj, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që pretendimet tona t'i konstatojë si të bazuara dhe të nxjerr:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: ''Aroma Plus'' SH.P.K

II. ANULOHET vendimi i AK-se për procedurën prokurimit lidhur me aktivitetin: Pastrimi i Hapësirave te brendshme te objekteve në QKUK me me nr. të prokurimit 701-23-10641-2-1-1: të iniciuar nga AK - QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVES dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Ne si OE kemi shpenzime të konsiderueshme në përgatitjen e dokumentacionit, ofertave dhe pjesëve tjera të cilat ndërlidhet me këtë procedurë të prokurimit, shpenzimet për sigurimin e Ofertës, Shpenzimet e Avokatisë si ne përgatitjen e

kërkesave për rishqyrtim ashtu edhe për përgatitjen e ankesës. Dëmi reflekton në dëmin material dhe jo material e i cili shtrihet edhe në raport me LMD neni 136, 137 duke mos u kufizuar edhe në dëmtimin e imazhit dhe pasojave të tjera që në këtë fazë nuk janë në tërësi të konkretizuara.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*